

UDC 316.422.42(73+4)

Murat ALIU, MA candidate<sup>530</sup>

## **POSTMODERNIZMI: FYTYRA E RE E MODERNIZMIT**

### **ПОСТМОДЕРНИЗМОТ: НОВОТО ЛИЦЕ НА МОДЕРНИЗМОТ**

#### **POSTMODERNISME: THE NEW FACE OF MODERNISME**

---

##### **Abstract**

By the end of the Middle Ages, and the decline of feudalism in the turn of the XVI, and XVII, centuries and the emergence of the modern paradigm in the Europe of that time, many crucial transformations took place in the social organization. The emergence of modernism perhaps represents the greatest revolution in the human history. The abandonment of traditions and the religion-based social order caused fundamental changes in the human life, both in the mental and material aspect. The development of economy and trade, the birth of states, industrialization, the evolution of technology, the emergence of ideologies and various political trends, and the shaping of scientific disciplines, constitute the backbone of modernization.

After the end of the Second World War, the phenomenon called “postmodernism” emerged in USA and Europe, which put forwards the discontentment towards the idea of the modern paradigm, blaming it for all the adversities that occurred to the human king, and at the same time offering new solutions and models for individuals and social organizations. In this context, we will give efforts to explain the phenomenon of postmodernism in terms of philosophy and social sphere.

---

<sup>530</sup> Student në studime pasdiplomike në Universitetin e Stambollit, Drejtimi Marrëdhënie Ndërkombëtare. murat.m.aliu@hotmail.com

To put it clearly, postmodernism denotes a reaction against the modernist ideas and, with its different ideas and models, challenges modernization in all fields and disputes the principles of knowledge in the modern paradigm, putting forth other ideas and answers for the life of humans and the society in general.

**Keywords:** Modernism, postmodernism, the Enlightenment, meta-narratives

### 1. SFONDI KONCEPTUAL I MODERNIZMIT

Modernizmi para së gjithash është një term, që rrjedh nga fjala latine *modo* që do të thotë “tash”, diçka që i takon se “tashmes”, pra është sinonim i bashkëkohores. Ky term për herë të parë është përdorur në shekullin V për të bërë dallimin e periudhës së re nga periudha e kaluar. Në këtë kontekst modernizmi ka një kuptim edhe më të gjerë. (Childs, 2010:22). Më vonë pas shekullit X janë përhapur termat *modernitas* “kohërat moderne” dhe *moderni* “njerëzit bashkëkohorë”. Termi modernitet dhe modernizëm në kuptimin filozofik, shkencor dhe social është paraqitur në shekujt XVII dhe XVIII, që përdorej për të përshkruar periudhën e ndryshimeve të mëdha në fushat e artit dhe letërsisë. Edhe, përkundër kësaj fillesat e modernizmit si lëvizje nuk janë të përcaktuara saktë as edhe specifikat e tij të përgjithshme, por formalisht paraqet reaksion dhe një lëvizje skeptike ndaj rendit të vjetër *paramodern* (Calinescu, 2013,21)

Modernizmi (modernism) nga aspekti semantik ka më tepër kuptim ideologjik, që në vete ngërthen nocionet “*modern*”, “*modernitet*” dhe “*modernizëm*”, në nivel më të lartë të institucionalizimit dhe ideologjizimit të vlerave të modernitetit. Modernizmi shpreh transformimin filozofik të lindur në periudhën e iluminizmit, transformim i cili shprehet nëpërmjet koncepteve si; humanizmi, individualizmi, laicizmi, demokracia, të cilat paraqesin një botëkuptim krejtësisht të ri për jetën e njeriut duke i ngarkuar atij obligime determinuese, pra, çlirimin e njeriut nga prangat e normave fetare duke e bërë atë mbizotërues në tokë nëpërmjet shkencës racionale (Demir, 2006:24). Sipas Renne Guenonit, Modernizmi paraqet

“*tendenca progressive të kishës në fund të shekullit XIX*”, dhe se mendimi modern nuk shpreh tjetër gjë, përveç se një prirje antitradicionale (antitraditionnel) (Guenon, 2012:41)

Modernizmi është një formë e të menduarit që identitetin e fiton nga mendimi iluminist, i cili konsiston në dominimin e racios dhe shkencës racionale mbi normat dhe doket fetare dhe tradicionale. Traditat, doket dhe autoriteti mesjetar zëvendësohen nga progresi, mirësjellja, civilizimi, racionaliteti dhe shpëtimi i njeriut. Kurse koncepti për Zotin zëvendësohet me konceptin alternativ të njeriut dhe racios (Demir, 2006: 24). Besimi në arsyen si forcë më e madhe dhe superiore, mospasja nevojë nga ligjërimet qiellore dhe normat fetare janë shtyllat kryesore të mendim modern. Ajo që nuk konceptohet nga arsyeja *a priori* është inekzistente (Cevizci, 2012:284). Sepse supozohet që, dija e bazuar në prova është më e lartë dhe besueshme se llojet tjera të dijes. Modernizmi veten e legjitimon me konceptet të prodhuara nga vet ai, duke i refuzuar të gjithë faktorët ekstern të ndikimit, siç janë tradita, autoriteti dhe religjioni (Demir, 2006: 24). Mendimi modernist, si një projekt i iluminizmit konsiston në mendësinë e përparimit linear dhe kontinuitiv. Ky progres sipas filozofisë iluministe mbështetet në qëllime të caktuara, shembull, synon krijimin e një rendi ideal shoqëror ose një individ të përsosur. Shpirti iluminist paraqet një disiplinë që siguron çlirimin e individit nga konceptet e ngushta irracionale dhe orienton në njohjen racionale dhe pjesëmarrje ne organizim racional.(Touraine, 2014:25)

### 1.1. Mendimi Iluminist

Iluminizmi si term shkencor, etimologjikisht rrjedh prej anglishtes “*light*”, që është ekuivalent me konceptin “*enlightment*”. Iluminizmi para së gjithash është lëvizje filozofike e cila fillon me revolucionin anglez dhe përfundon me revolucionin borgjez francez. Miti që njeriu është “robëruar” nga rendi i vjetër tradicional, shpëtimi i tij si dhe futjen e tij në rendin e ri racional dhe çlirues janë intencat kryesore të kësaj lëvizje. Kjo lëvizje orientohet kundër rendit

feudal dhe kulturës së tij, kundër obskurantizmit mesjetar dhe të gjitha formave të mendësisë së “prapambetur” (Çiğdem, 2013:13-14).

Iluminizmi përshkruan periudhën e historisë njerëzore, ku arsyeja dhe mendimi individual bashkohen në një formë të fuqishme, që konceptimin e botës e bazojnë në metafizikën dhe zëvendësimin e shoqërisë tradicionale me atë të informacionit (Çiğdem, 2013:23). Në këtë periudhë themelet e shoqërisë fetare fillojnë të humben, sepse iluminizmi në esencë shpreh mendimin reaksionar ndaj paradigmes fetare. Kritika ndaj paradigmes fetare, mënyra e shpjegimit të fenomeneve natyrore, shoqërisë dhe rendit shtetëror e bën atë specifike. Ekzistenca e qenieve duhet dëshmuar ose refuzuar vetëm në përputhshmëri me parametrat racional (Uyanık, 2006: 21). Ne saje të përdorimit të racios përjashtohet mënyra e determinimit transcendentale të mënyrës së jetës, punës dhe zbatimit (Çiğdem, 2013:28).

Alan Touranie, shpirtin iluminist e përkufizon si një disiplinë që edukimin individual e orienton në një shpjegim të ngushtë racional dhe shpëtimin nga gjithçka që nuk është rationale, kurse si qëllim final synon organizimin e shoqërisë nëpërmjet përdorimit të arsyes dhe metodave racionaliste (Alan Touranie, 2014: 25.26). Besimi në arsyen ngërthen kritikë të fuqishme ndaj traditës, religjionit dhe autoritetit që kufizojnë të vërtetën të bazuar në principet e mendimit shkencor dhe transformimin e strukturës shoqërore në atë që drejton forca e racios. Individu sipas filozofisë iluministe duhet shmangur besimeve dogmatike transcendentale, në vend të pritjes që ndonjë forcë e jashtme të përcakton fatin e tij, individit si qenie e pavarur duhet të vendosë vet me vullnetin e tij të lirë. Prandaj bashkë me iluminizmin në botën perëndimore shfaqet koncepti “*homocentirizmit*”, që në esencë destinon individin të jetë determinues i fatit të tij (Babaroğlu, 2002:19).

Mendimi iluminist që paraqet derivat i mendimit të periudhës së rilindjes dhe reformacionit si lëvizjeve antifetare, së bashku sjellin edhe konceptet e lirisë, arsyes, individit, të drejtave dhe lirisë të njeriut, kontratës sociale, shekullarizmit, demokracisë, barazisë, mendimit shkencor, të cilët paraqesin koncepte bazë për projektimin

e rendit të ri shoqëror. Bashkë me lëvizjen iluministe është bërë ndarja (përcaktimi) i kufijve të religjionit, filozofisë, shkencës dhe artit, që sipas Habermasit përbejnë esencën e “*projektit modernist*”

## 1.2 Modernizimi

Modernizimi, një term ky i përfituar nga shprehja “*modern*”, tregon procesin e zhvillimit ekonomik shoqëror. Në këtë kontekst modernizimi përbën një proces të pavarësimit shoqëror dhe të diferencimit kulturor. Modernizimi është emër i përgjithshëm i ndryshimeve dhe transformimeve të realizuara në sferën sociale, politike, ekonomike, kulturore, me synim të përvetësimit të strukturës, institucioneve, vlerave, dhe sistemeve të shoqërive perëndimore të industrializuara. (Demir, 2006: 22-23). Institucionalizimi i vlerave moderniste është një ndër indikatorët themelorë të modernizimit.

Modernizimi, është një nocion eurocentrik, që përdoret nga sociologët dhe historianët për ta definuar procesin e transformimit të madh shoqëror që ka filluar në fund të Mesjetës në fushat sociale, ekonomike, kulturore dhe politike dhe që vazhdon sot e kësaj dite (Për shoqëritë e pamodernizuara). Modernizimi paralajmëron procesin e transformimit dhe ndryshimeve rrënjësore të shumëanshme dhe shpreh një shkëputje strukturore dhe rrënjësore nga ajo që është tradicionale ose e rendit paraprak. Zhvillimi teknologjik dhe shpikjet teknologjike përbëjnë njërin ndër elementet kyçe të këtij procesi. Në këtë kontekst modernizimi reflekton edhe proceset ideologjike dhe shkencore si, pozitivizmin, nacionalizmin, kapitalizmin, industrializimin, urbanizimin, laicizimin, burokracinë dhe procese të ngjashme të cilat nxjerrin në pah një mënyrë të re të jetës dhe organizimit social. Rrjedhimisht me këtë duhet theksuar që, zhvillimi teknologjik ose elementi material nuk është kusht i vetëm i modernizimit, sepse ky proces përmban edhe elementin ideologjik dhe filozofiko-social, që ka shkaktuar edhe ndryshimin e mënyrës së të menduarit.

Fusha e jurisprudencës është njëra ndër fushat ku më së shumti mund të vërehet ky ndryshim diskursi, zëvendësimi i së drejtës hyjnore me të drejtën laike është një indikator i qartë për rëndësinë

e këtij procesi. Me zhvillimet e shekullit XVII. dhe me pas, individit më nuk është i obliguar të krijojë marrëdhënie shoqërore mbi baza fetare, në këtë periudhë shfaqet mendimi dominant i lirisë, barazisë dhe individualizmit. (Yılmaz: 1998: 25). Mendimi kritik ndaj predikimeve qiellore, sistemit ekonomik feudal, despotizmit politik, obskurantizmit, rendit juridik, moralit, historisë përbën boshtin kryesorë të paradigmes moderne. Pra, shenja specifike e lindjes së modernitetit është kritika. Ajo që e karakterizon periudhën moderne është hulumtimi, skepsa ndaj fenomeneve dhe metodologjia shkencore. Konceptet dhe idetë themelore të kësaj periudhe artikuloohen nëpërmjet nocioneve progres, evolucion, revolucion, liri, kontratë sociale, demokraci...Të qenurit modern orienton në prirjet individuale autonome kundrejt traditës historike dhe autoritetit të jashtëm. Prirjet e këtilla manifestohen me dëshirën e individit për vetëudhëheqje dhe autonomi themelore.(Küçük, 2011:124)

Sipas sociologëve Durkheim, Simmel, dhe Parsons, mbështetës të modernitetit, vlerësojnë se, moderniteti paraqet një mënyrë jetese që na inkorporon vlerat si, heterogjeniteti, individualizmi, perfekcionizmi, marrëdhëniet të bazuara në kontratë, zhvillimi teknologjik, njohuritë shkencore. Në vija të trasha parametrat themelore të modernitetit janë kapitalizmi, industrializimi, urbanizimi, demokracia, racionalizmi, burokracia, shteti-komb. Duke u bazuar në këtë procesi i modernizimit paraqet kryengritje ndaj funksionimit të normave shoqërore tradicionale dhe se ky proces fillon me refuzimin e asaj që është normative. Ky refuzim drejtpërdrejtë rezulton edhe me pasivizimin e normave morale të mëparshme. Sipas Kantit, klasifikimi i koncepteve në shkencë, moral dhe art përbën bërthamën themelore të projektit të modernitetit.

## 2. POSTMODERNIZM VERSUS MODERNIZM

Ngjarjet historike të shekullit XX. me ndikim në përmasa botërore, si gjenocidi nazist kundër hebrenjve, hedhja e bombës atomike në Hiroshimë dhe Nagasaki, lufta në Vietnam, kriza ekonomike e viteve 70 si dhe një sërë ngjarjesh tjera të cilët tronditën botën

perëndimore kanë shkaktuar fillimin e rishikimit të filozofisë dhe bindjeve të paradigmes iluministe. Rrjedhimisht me këtë postmodernizmi ka ngritur flamurin e rebelimit kundër të gjitha vlerave dhe institucioneve të shenjtëruara nga periudha moderne dhe aty nga vitet 70 te shekullit XX. ka filluar të shndërrohet në lëvizje tërheqëse për një pjesë të madhe të intelektualëve perëndimorë. Postmodernizmi u bë emër i një lëvizjeje që ka mbërthyer të gjitha fushat e jetës njerëzore. Si i tillë në fillim paraqitet në fushën e artit e me pastaj, në kinematografi, arkitekturë, letërsi, muzikë, politikë, filozofi, ekonomi dhe në përgjithësi në mendimin social. (Demir: 2006: 93)

Nocioni “*post-modernizm*”, për herë të parë është përdorur në vitin 1939 nga ana e historianit Arnold Toynbee në veprën e tij “*Studimi i historisë*”, me qëllim të klasifikimit të periudhës moderne, që sipas tij, përfshin çerekun e tretë të shekullit XIX, pra 1850-1875, dhe se pas kësaj periudhe historia në mënyrë të pavetëdijshme hynë në një fazë tjetër shoqërore të quajtur “Post-modernizm”. Toynbee në shkrimet e tij supozon se periudha e modernitetit mbaron bashkë me luftën e parë botërore, kurse fillet e para të postmodernitetit paraqiten në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. (Calinescu, 2013:295)

Termi Postmodernizm nga aspekti semantik shpreh një gjendje “*përtej modernes*”, “*pas modernes*” ose “*mbi modernen*”, që në esencë është një konceptet tepër i komplikuar dhe i papërcaktuar. Postmoderniteti si i tillë nganjëherë paraqitet si term skajshmërisht kompleks dhe filozofik, kurse nga ana tjetër definohet me terma tejet të thjeshtë duke e paraqitur atë si prirje cinike dhe nihiliste të kulturës bashkëkohore. Ky term, konceptualisht përfshin një diapazon të gjerë teorik, duke filluar nga estetika, funksionimi i shoqërisë, zgjidhjet teorike deri te shkencat e filozofisë. (Calinescu, 2013:296).

Teoricentë të ndryshëm postmodernizmin e përkufizojnë në mënyra të ndryshme. Loytardi do të thoshte se; “Postmodernizmi përshkruan përdhën e informacionit në shoqëritë të zhvilluara ose skepticizmin ndaj grand-narracioneve”, David Harvey, “Postmodernizmi paraqet një strukturë dhe mënyrë të re të mendimit”, Kellneri e emërton si “përdhja e teknokapitalizmit”, Jamesoni “logjika e

vonuar e kapitalizmit” kurse Baudrillardit si periudhë e simulacionit, hiper-realizmit dhe nihiliste”.(Kızılcelik, 1996:23). Shumica e këtyre teoricienëve janë mbështetës të diskursit postmodernist dhe njëkohësisht kritikues të paradigmës moderne. Me diskursin postmodern vjen në shprehje edhe rishqyrtimi i koncepteve baze të modernitetit. Ky rishqyrtim fillon me kritikën ndaj meta-narracioneve utopiste, universalizmit, esencializmi, reduksionizmit, racionalizmit dhe pozitivizmit historik. Postmodernizmi paraqet rezultat i kornizave të paradigmës moderne të projektuara nga filozofët iluministë që, sipas postmodernistëve shkaktojë krizë në prodhimin shkencor dhe mendor në perëndim. Fenomeni i postmodernizmit interesohet gati se për çdo fushë , duke filluar nga arkitektura deri te zoologjia, biologjia, historia, letërsia, politika, filozofia, arti, drejtësia (si disiplinë shkencore), antropologjia. Por përsëri mundë të themi që qëndron si një trup të paformësuar dhe papërcaktuar sakte. Refuzimi i supozimeve epistemologjike, injorimi i parimeve metodologjike, rezistimi dhe skepticizmi ndaj të dhënave shkencore, mjegullimi i të gjitha versioneve të së vërtetës, indiferenca ndaj politikës, janë vetëm disa nga veçorit kryesore të këtij diskursi.

Ekzistojnë mendime të ndryshme rreth çështjes se diskursi postmodern a paraqet shkëputje totale nga moderniteti dhe refuzimin e tij total, dhe si tiilë paraqitet si alternativ, apo thjeshtë është vazhdimësi e modernitet. Në lidhje me këtë polemikë mund të themi që postmodernizmi në vend të refuzimit të tërësishëm shfaqet si një lëvizje reaksionare ndaj disa temave-koncepteve moderniste. Pra nuk bëhet fjalë për një refuzim total të paradigmës moderne. Sipas Loytardit, *“postmodernizmi është pjesë e modernizmit, ai nuk është një modernizëm që ka përfunduar, por është modernizëm në gjendje të lindur”*. Kurse, Habermasi shtron tezën se, postmodernizmi paraqet një projekt të papërfunduar të modernitetit dhe se konceptet esenciale të inkorporuar brenda paradigmës postmoderne veç se janë prezente edhe në paradigmen moderne.(Featherstone, 2011:18) Sidoqoftë, transformimet e mëdha strukturore në gjysmën e shekullit XX. dhe fillim te XXI. të reflektuara ne filozofi, shkencë, art, letërsi,

arkitekturë dhe fushat tjera, na bëjnë të mendojmë që këto transformime paraqesin një gjendje “post-moderne”.

Veçoritë themelore të postmodernizmit janë të kundërtat e modernizmit. Kështu që, postmodernizmi kundër teorive totalitare inkorporon pluralizmin, në vend të universalizmit lokalizmin dhe partikularizmin, e vërteta zëvendësohet me interpretimin (hermeneutikën) dhe relativitetin, në vend politikës dhe etikës estetikën, kritika ideologjike zëvendësohet me dekonstruktivitetin, realizmi zëvendësohet me imazhet, përfaqësimi zëvendësohet me simulimin, hapësira zëvendësohet me kohën, llojllojshmëria në vend të kundërtënieve, në vend të klasave inkorporohet identiteti, domosdoshmëria zëvendësohet me kaosin dhe rastisjen. (Callinicos, 2004:15)

Mendësia moderne është shkaku kryesor për hapjen e rrugës së postmodernizmit, postmodernizmi lind si reaksion ndaj kësaj mendësie, në fillim duke refuzuar ligjërimet totalitare për konceptin e shkencës, anashkalimin e sentimenteve të individit nga ana e racionalizmit ekstrem, rezultatet shkatërruese të pushtetit të instrumentalizuar racional, meta narracionet tipike të moderniteti etj. Të gjitha këto kanë formësuar mendimin postmodern. Kriteret bazë mbi të cilat ndërtohet paradigma moderne janë progresi dhe logjika-arsyeja, kurse postmodernizmi si alternativ të këtyre dy kriterëve vendos “anomalinë” dhe “paqartësinë-papërcaktueshmërinë” si bazë për analizën e shoqërisë. Kështu debati polarizohet rreth dy pozicioneve epistemologjike që përplasen njëra me tjetrën. Nga njëra anë modernizmi me besimin e tij në fuqinë e arsyes shtron tezën që, nëpërmjet arsyes mund të arrihet deri te shoqëria ideale, kurse nga ana tjetër, postmodernizmi kategorikisht refuzon këtë mendësi si totalitare, dhe akuzon këtë mendësi për fatkeqësitë njerëzore.

Sipas pjesëtarëve të shkollës së Frankfurtit, Horkheimert dhe Adornos në veprën e tyre *The Dialectic of Enlightenment* (Dijalektika e iluminizmit) mendojnë që logjika që shtrihet pas racionalizmit iluminist paraqet një logjikë totalitare dhe shtypëse. Dëshira për dominimin e natyrës hap rrugën edhe për dominim ndaj njerëzve.

Horkheimer dhe Adorno rrugëdaljen e vetme nga ky qorrsohak e shohin në rebelimin e natyrës.

Njohja postmoderne shpreh prirjet për çlirimin e individit nga monopoli i krijuar nga moderniteti. (Loytard 2013:8). Postmodernizmi mbron fragmentalizmin. Por postmodernizmi me vete parashitesën “*post*” nënkuptojmë se shpreh pakënaqësi në vetvete ndaj diçka të mëparshme dukë bërë revizionimin, reformimin ose refuzimin të asaj paraprakes. Postmodernizmi në përkufizimin e sërishëm të diskursit kulturorë, favorizon heterogjenitetin dhe diversitetin si forca çliruese dhe shpreh një skepticizem të thellë ndaj narracioneve totalitare. (Harvey:2012:21) Njeriu postmodern përjashton çdo forcë e integritit, qoftë ky integritet shoqëror, shkencor apo edhe estetik. Subjekti i paradigmes postmoderne, paraqet një subjekt inicues që rishqyrton praktikën e nënshtrimit dhe varësisë dhe që gjithmonë është në kërkim të ndërtimit të modeleve alternative. Shkaku i kësaj qëndron vetvetiu në epistemologjinë gjuhësore si sistem i hapur. Diskursi natyror i gjuhës pengon dialektikën identike. Postmodernizmi në kundërshtim me miratimet tradicionale moderne pohon që, njohuritë tona janë relative të cilat në kontinuitet duhet riprodhuar dhe për këtë nevojitet zhvillimi i modeleve të reja. (Küçük, 2011: 223). Kryengritja kundër esencializmit është njëra ndër specifikat të këtij diskursi, i cili në brendi ndërthet elemente neo-konservative dhe anti-iluministe dhe kundërshton uniformitetin modernist. Postmodernizmi fillon me kritikën ndaj narratives që shenjtëron arsyen dhe shkencën. Marrja për bazë vetëm disa faktorë për shpjegimin e fenomeneve të ndryshme sociale, është e papranueshme. Konceptimi i njohjes në postmodernizëm nuk reduktohet në subjektiven ashtu siç parashihet empirizmi dhe racionalizmi. Për këtë shkak duhet rezistuar kundër reduksionizmit, esencializmit dhe fundamentalizmit, sepse të vërtetat nuk janë njohuri që mundë të përcillen, por ato vazhdimisht shpiken ose prodhohen. Pikërisht për këtë asnjë botë-kuptim nuk mundë të krijojë monopol legjitimues mbi këto kategori.

Një specifikë tjetër e postmodernizmit është mospranimi dhe kritika e ashpër që u bëhet “grand-narracioneve”, çliruese-marksiste,

terapisë psikonalitike-frojdiene si dhe teorive evolucioniste darviniste, të gjitha këto si ligjerime totalitariste. Sipas Loytardit grand-narracionet nënkuptojnë teoritë sociale dhe historitë e mëdha filozofike që shoqërinë dhe historinë njerëzore e shpjegojnë brenda kornizave subjektive, përgjithësuese dhe reduksioniste. Pra bëhet fjalë për filozofit e mëdha historike dhe teoritë e ndryshme totoalitare. Shpëtimi i individit duhet kërkuar në vlerat lokale të kufizuara dhe jo brenda kornizave të meta narracioneve. Postmodernizmi kundërshton qasjet të cilat bartin idealin për formësimin e një shoqërie homogjene dhe unike, me arsyetimin se shpëtimi i punëtorëve, grave, të shtypurve, progresi njerëzor, shoqërinë pa klasa, zhvillimin, përndritjen e shoqërive mund të realizohet vetëm nëpërmjet metodave autoritare dhe shtypëse. Në këtë kontekst qëllimi politik i postmodernizmit është shkatërrimi i tërësisë hierarkike dhe krijimin e një rendi kaotik. (Demir, 2006: 44). Postmoderniteti marksizmin, krishterizmin, fashizmin, stalinizmin, liberal demokracinë, feniminizmin, Islamin dhe shkencën moderne i redukton në një shkallë të njëjtë dhe të gjitha këto ideologji zgjidhjen e problemeve sociale e realizojnë me një metodologji dhe japin përgjigje të planifikuara paraprakisht dhe që këto narracione janë transcendentale dhe totalitare. Rrjedhimisht me këtë tendencat për shpjegimin e jetës duke u bazuar në idealet e lirisë, barazisë, drejtësisë, racionalizmit janë të pavlefshme sepse këto koncepte kanë humbur legjitimitetin burimor. (Kızılcelik. 1996: 25).

Relativizmi paraqet ndoshta konceptin themelorë të paradigmes postmoderne. Asnjë teori nuk mund të paraqesë zgjidhje universale për problemet shoqërore, Çdo teori mund të jap zgjidhje të pjesshme. “Të vërtetat nuk ekzistojnë brenda teorive, por të gjithë të vërtetat janë të kufizuara nga teoritë”, për çdo problem në të njëjtën kohë mund të ekzistojnë më shumë zgjidhje të vërteta, ose mund të mos ekzistojnë asnjë zgjidhje praktike. (Şaylan, 2009: 19)

Fryrja e dijes objektive, mënyra jo kritike e shkencës moderne në fushat shoqërore, paraqet edhe një arsye për lindjen e postmodernizmit dhe reagimin e tij ndaj këtij fenomeni. Shikuar historikisht, sulmet dhe kritikrat më të shumta ndaj shkencës moderne kanë

ardhur nga kisha e cila atë kohë legjitimohej nga ligjërimet qiellore. Me objektivitetin e shkencës moderne dhe metodologjinë e saj të ngurtë, duke i dhënë përparësi materiales, gjithmonë është anashkalluar metafizika dhe misticizmi. Kështu shkenca fillon me monopolizmin e së vërtetës objektive. Me zgjerimin autoritet, në mënyrë të irracionale dhe arbitrare përjashtohen të gjitha autoritetet të mëparshme dhe shpallen delegjitimë. Pikërisht ajo që kundërshtojnë posmodernistët është qëndrimi jokritik ndaj trashëgimisë iluministe dhe supozimeve metodologjike të shkencës moderne.

Përgjithësisht, postmodernizmi, pohon që e vërteta përbëhet nga imagjinata dhe është relative, e jo absolute, kështu postmodernizmi duhet vlerësuar si një diskurs i cili kundërshton çdo lloj mendimi dhe prirje “përfundimtare” të ligjëruara nga diskursi modern. Në këtë drejtim postmodernizmi, paraqet një intencë mendimi që shqyrton dhe sfidon tendencat absolute dhe përfundimtare të modernitetit, si dhe proceset të cilët korrespondojnë më këto tendenca (sundimi i njohjes shkencore, pozitivizmi, humanizmi, kapitalizmi, burokracia, shekullarizmi, shteti-komb, industrializimi, teknologjia, iluminizmi...). Thënë ndryshe, postmodernizmi, te gjitha meta narracionet të shpikura nga modernizmi i sheh më një dozë të madhe mosbesimi. Si përgjigje të meta narracioneve, postmodernizmin, paqartësinë, fragmentalizmin, llojllojshmërinë, etnikumin, subkulturën, pluralizmin kulturor, lokalizmin, originalitetin, autenticitetin...pra, është një lëvizje që si zgjidhje ligjëron mikro-narracionet. Në këtë kontekst krijimin e një bote heterogjene dhe pluraliste (Kumar, 2013:134-135).

Armët bërthamore dhe kimike, luftërat e përgjakshme, varfëria dhe uria, tjetërsimi dhe robotizimi i individit, përdorimi i njohurive shkencore për qëllime personale politike dhe fajësimi për mbijetesën e shteteve totalitare, rritja e dallimeve në mes realitetit dhe teorisë në shkencën moderne, indiferenca ndaj dimensioneve mistike dhe metafizike të qenies së njeriut, si dhe konkretizimin e shkencës duke injoruar ndjenjat, janë indikatorë relevant në dështimin e realizimit të premtimeve të dhëna si dhe përgënjeshtrimi në besimin e gabuar se shkenca moderne mund t’u përgjigjet të gjithë

pyetjeve në botë. Të gjithë këto përbëjnë faktorët për paraqitjen e postmodernizmit. Sipas Loytardit, konsumimi i meta narracioneve si forcë legjitimuese të modernitetit, ka hapur debatin për mbarimin e këtij diskursi dhe lindjen e një diskursi tjetër.

Përgjatë shumë viteve me sjelljen e një misionari, modernistet u përpoqën ta imponojnë bindjen se modelet e sistemit politik dhe ekonomik modern janë universale, por ndodhi e kundërta filloj të kuptohej se këto parime nuk janë universale, dhe janë të projektuara në favor të shteteve të zhvilluara. Dalja në pah e standardeve të dyfishta të demokracisë liberale, lirive dhe te drejtave të njeriut kanë lehtësuar shqyrtimin e të gjithë versioneve të mendimit *homocentrist* perëndimor. Dështimi i marksizmit që me idetë e tij u paraqit si shpresë për shumë shoqëri, shkaktoi një zhgënjim të madh ndër këto shoqëri, e si rrjedhojë e kësaj janë krijuar kushtet për një kryengritje ndaj modernizmit (Kizilcelik 1996:89). Kështu postmodernistet duke mos u mbështet në filozofinë tradicionale kanë filluar të zhvillojnë të kuptuarit kritik të shoqërisë dhe që filozofinë dhe teorinë sociale në përgjithësi nuk e mbështesin mbi baza të filozofisë moderniste. Bashkë me braktisjen e fundamentalizmit vjen në shprehje edhe braktisja e diskursit filozofik si kryesor në kritikën shoqërore. Kjo do të thotë, që kritika kundër mendësisë moderniste mund te realizohet pa mos u bazuar ne themelet teorike universale. (Kuçuk 2011: 278). Postmodernistet të cilët dolën kundër epistemologjisë, historisë, shoqërisë, kulturës, thelbit universal, vetëm ndaj heterogjenitetit nuk janë kundër. Iluminizmi, kapitalizmi, demokracia, barazia, marksizmi dhe të gjitha meta narracionet e tjera. Postmodernizmi lind para së gjithash një rebelim kundër modernitetit dhe qërim hesapesh me modernizmin. Postmodernizmi paraqet një emertim të shoqërive të zhvilluara, pra, shoqërive post-industriale.

### 3. PIONERËT E MENDIMIT POSTMODERN

Termi "*postmodern*" në fillim më së shumti është përdorur në fushat e artit dhe më vonë edhe në fushën e filozofisë dhe mendimit social. Sado që postmodernizmi të ketë lindur në SHBA në debatet

artistike, postmodernizmi si i tillë, diku rreth viteve '70 të shek. XX u paraqit në Francë duke përfitur nga punimet e mëparshme të teorive kulturore dhe shoqërore. Emrat më të theksuar të kësaj lëvizje janë: Baudrillard, Loytard, Derrida, Foucault, Hassan, Spanos, Sontag, Fidler, Deluze, Roland Barthes, Jemson, Ferdinand de Saussure, Guy Debord. (Feratherstone: 2013-21)

### 3.1 Loytard

Loytardi shpeshherë llogaritet edhe babai i mendimit postmodern dhe është njëri ndër emrat më të spikatur të këtij diskursi. Loytardi në mënyrë kategorike refuzon qëndrimet racionale filozofike dhe parimet e universalizmit të paraqitura nga moderniteti. Sipas tij periudha postmoderne paraqet një etapë e re të historisë e cila dëshmon vjetërsimin dhe anakronizmin e periudhës moderne. (Loytard, 2013,45) Shprehja të vjetërsuara dhe anakronike aludon në narracionet të cilët legjitimojnë shkencën moderne dhe shtetin. Loytardi, në veprën e tij *“Gjendja Postmoderne”*, në mënyrë eksplite del kundër njohjes universale dhe logjikës integrativiste. Sepse sipas tij e vërteta është nocion relativ dhe jo absolut. Loytardi mendon që modernizmi më së shumti i ka zhvilluar narrativin iluminist dhe idealizmin Hegelian. Paradigma iluministe me premtime që do ta shpëtoj individin nga injoranca dhe errësira në emër të scientizmit duke e shtrirë racion në çdo fushë të jetës ka synuar legjitimimin e vetes. Racioja në politikë, filozofi, shkencë, prodhimtari, moral është paraqitur si autoritet i vetëm. E meta kryesore të këtyre narracioneve sipas Loytardit, është natyra dhe struktura e tyre autoritative, të cilat duke i bërë presion individit kanë shkaktuar privimin e tij së qenurit individ. Këto forma të shoqërive janë transformuar në modele totalitare.

Postmodernistët për dallim nga modernistët kurrë nuk kanë i kanë aplikuar meta- narracionet, sepse këtyre nuk u besojnë. Sipas postmodernistëve narracionet si shoqëria pa klasa, çlirimin e klasës punëtore, vlera universale etj... kanë humbur legjitimitetin dhe vlefshmërinë e tyre. Perspektiva postmoderne, për dallim nga mendësia moderne, grand-narracionet i zëvendëson me mikro-

narracione, sepse këto mundësojnë njohjen fundamentale të shkencës dhe risive imagjinale. (Sarup:2004:209). Kështu Loytard, mendon që tregimet e mëdha janë të këqija, kurse ato të voglat të mira, këtë klasifikim e shpreh nëpërmjet ndarjes “e madhe” dhe “e vogël”. Loytard, duke dhënë shembuj të bazuara në teoritë dhe praktikat e ideologjive marksiste dhe liberale, kritikon filiozofinë universaliste e cila nëpërmjet një grup parimesh dhe aksiomash empirike dhe racionale ushtron presion ndaj subjekteve shoqërore. Pikërisht për këtë shkak në vend të preferuarit të grand-narracioneve me natyrë totalitariste, duhet preferuar mikro narracionet. Postmodernizmi paralajmëron fundin e një bote dhe fillimin e një bote tjetër. Racionalizmi i iluminizuar dhe bota e tij variable metafizike dhe pozitiviste paraqet fundin e botes eurocentiste, botës së mashkullit, te bardhit etj... madje edhe te racizmit, empirializmi dhe të shumë fenomeneve që sot janë anakroike. (Mehmet Küçük:2011:68-69)

Loytard, pohon që, ndryshe nga modernizmi, postmodernizmi nuk paragjykon heterogjenitetin dhe diversitetet si koncepte sociale, por i pranon si diçka esenciale, sepse në vetvete para së gjithash ngërthejnë tolerancën si vlerë. Sipas tij, individit me çdo kusht duhet dhënë liria e vullnetit dhe shprehja e dëshirave, sepse esenca e jetës së njeriut është liria ontologjike, kurse modernizmi bashkë me mekanizmat e tij ka privuar individin nga vullneti subjektiv dhe shprehja e dëshirave personale, duke synuar formësimin e individit sipas projeksioneve të vetë mendësisë absolute. Prandaj çlirimi i dëshirave dhe kërkesave është i domosdoshëm, sepse kështu do të vjen deri te çlirimi edhe i njerëzimit nën presion të kësaj shtypje, në këtë pikë mund të themi që mendimi i Loytardit nuk diferencohet nga ai i Nitchez dhe Hiddegerit, edhe pse ato në asnjë rast nuk kanë përmendur termin “postmodern”. Paralelisht me shfaqjen e postmodernizmit mund të flitet edhe për çlirimin e individit nga shtypjet e filozofisë moderniste. Ky çlirim nuk mund të arrihet në fushën e njohjes ose epistemologjisë, sepse njohja ushtron presion ose shtypje ndaj dëshirave. Dëshirat mund të arrijnë nivelin e çlirimit në fushën e artit dhe të shkrimit (Şalyan:2009:339-340). Ai vazhdon edhe më tej

duke pohuar që artistet duhet te intervenojnë në pjesët e plagosura të shoqërisë duke i shëruar ato. Sepse zhvillimet shkencore dhe teknologjike nuk lumturojnë individin, por që ato bëhen shkak për dhimbje dhe shqetësime të ndryshme. Dija postmoderne nuk është një mjet i thjesht i autoriteteve si në modernizm, por ajo ka një qëndrim sensibil naj diversiteteve dhe diferencave. Këto janë disa prej arsyeve pse Loytard kundërshton mbizotërimin e shkencës moderne dhe racios.

### 3.2 Baudrillard

Është mendimtar i cili veten në nivel teorik e përkufizon si teoricien dhe nihilist dhe që gjate hulumtimeve të fenomeneve shoqërore nuk përdorë kurrë metodologji të caktuar por demetodologjia paraqet metodën më të mirë. Nëse vështrojmë strukturën mendore të Baudrillardit do të vërejmë që analizat për shpjegimin e fenomenit postmodern mundohet ti shpjegoj brenda kornizave të teorive të shkollës së Frankfurtit siç janë industria kulturore dhe periudha post-industriale. Periudha postmoderne sipas Baudrillardit përshkruan periudhen e “*simulacionit*”, “*imitimit*” dhe “*hiper-realizmit*”. Përderisa modernizimi identifikohet me shoqërinë industriale dhe prodhimin masiv, ne periudhën postmoderne simulacionet dhe imitimet janë burimi si të vërtetës të cilët projektojnë dhe kontrollojnë rendin shoqërore sipas projeksioneve të veta (Baudrillard, 2012:15). Baudrillardit i ndikuar nga mësimet të shkollës së Frankfurtit, postmodernizmin e analizon nga aspekti socio-kulturor. Sipas tij, procesi i kalimi nga modernizmi në postmodernizëm detyrimisht është i ndikuar edhe me evoluimin dhe revizionimin e sistemit kapitalist. Individit në postmodernizëm paraqitet si qenie *konsumese* i cili beson që kjo mund të sjellë lumturi ontologjike. *Shoqëria e konsumit* paraqet një formacion të ri shoqëror dhe ky formacion legjitimohet me “*racionalizimin*” e sistemit prodhues, “*individët nuk pranojnë të transformohen në një objekt, por inkurajohen të bëhen sistem objektesh, kështu individit nëpërmjet metodave të konsumit hynë në një proces njohjesh që shpie deri te supozimi se dallohet nga*

*individët e tjerë, po që në të njëjtën kohë integrohet në shoqërinë e konsumit si pjesë e saj*” (Şaylan, 2009:300). Thënë ndryshe, ky paraqet një proces i objektivizmit të individit. Objektet e konsumit paraqesin faktorë të rëndësishëm në formësimin e sjelljeve psikologjike të individit dhe në këtë mënyrë posedojnë mekanizmat e drejtpërdrejta funksionale. Sepse sipas Baudrillardit, konsumi është sjellje funksionale dhe shoqërore, njëkohësisht paraqet një “moral” dhe “institucion”, konsumi në kuptimin e plotë të fjalës paraqet komplet i një sistem vlerash (Budrillard:2012:94)

Për dallim nga marksizmi që e gjithë filozofinë dhe mendimin e tij e mbështet në materializmin historik dhe gjithçka redukton në prodhim, Baudrillard duke u referuar në teorinë post-strukturaliste pohon që, prodhimi nuk është problemi kryesor brenda formacionit të ri shoqëror. Shpikjet e reja teknologjike (media, bota e kompjuterëve, proceset informative, industria zbavitëse) kanë zëvendësuar prodhimin masiv industrial duke ardhur në pozitë të organizimit të rendit shoqëror në fushën politike dhe ekonomike.(Şaylan:2009:302). Pra, kjo gjendje e re paralajmëron edhe fundin e teorisë moderne dhe fillimin e një periudhe të re në të gjitha fushat. Periudha postmoderne ka zhvilluar idetë dhe konceptet postmoderniste si përfaqësues të së drejtës dhe të vërtetës dhe me këto teori rendi shoqëror ka pësuar një ndryshim radikal duke formuar dhe zhvilluar sistem vlerash autentike.

Në periudhën e re, para nesh na paraqitet një e vërtetë operationale e cila prodhohet sintetikisht dhe që është privuar nga ndarja e së vërtetës dhe fikcionit dhe si e tillë e vërteta është simulative. Baudrillard me konceptin e “Simulacionit”, në fakt mundohet të dëshmojë që periudha postmoderne nuk është reale, sepse në thelbin e nocionit “simulim” qëndron një kuptimin inekzistent e paraqet si ekzistent, por në fakt na paraqet vetëm fikcione dhe imagjinata. Ajo që është konkrete është zëvendësuar me simbolet, imazhet dhe fikcionet e ndryshme. Baudrillard, shkon edhe më tej duke pohuar që, ashtu si koncepti i së “vërtetës” edhe koncepti i lirisë e ka humbur kuptimin, dhe sikur në një farë mënyre është transformuar në rob vullnetarë.

Si përfundim, mund të themi që kritika kryesore që i bën Baudrillardit modernizmit është se modernizmi të vërteten objektive dhe racionale e percepton si një shans me të cilën produktet e saj i përdorë si aparat të instrumentalizuar, kështu teoricieni në fjalë pohon që njeriu u mund nga vet qenia e tij. Baudrillard i cili mendon që morali perëndimore është shkatërruar, thotë që përveç shoqërive perëndimore duhet shikuar edhe ato joperëndimore.

#### 4. KRITIKAT NDAJ POSTMODERNIZMIT

Postmodernizmi si diskurs shoqëror përveç mbështetësve të tij në nivel teorik dhe praktik, është ballafaquar edhe më një sërë kritikash po në të njëjtat nivele. Gellner, Giddens, Touraine, Habermasi njihen si kritikuesit më të zëshëm të teorive postmoderne dhe në të njëjtën kohë edhe mbështetës të paradigëmës moderniste. Sipas tyre, refuzimi i moderniteti jo vetëm që nënkupton refuzimin e vlerave moderniste, por edhe refuzimin e esencës të saj, gjë që mund të shkaktoj kaos politik dhe epistemik. Sipas Kellnerit, edhe Foucault edhe Derrida nuk kanë prodhuar teori shoqërore postmoderne, përveç kësaj edhe shkëputja ndërmjet modernitetit dhe postmodernitetit nga ana e Baudrillardit edhe Lyotardit është teorizuar në nivel të lartë, gjë që nuk përcaktojnë qartë dallimet ndërmjet këtyre dy diskurseve. Në polemikat të teorisë shoqërore të ndarjes së postmodernizmit nga modernizmi nuk janë përcaktuar pikat kyç që destinojnë në këtë. Pikërisht për këtë Kellneri mendon që, postmodernizmi është një projekt teorik i dështuar. Në këtë kontekst sipas Hellerit dhe Fehretit, postmoderniteti është një prirje politike dhe kulturore, që nuk i ka përkufizuar specifikat e vet edhe nuk duhet paraqitur si periudhë të re historike (Bayhan, 2006, 87)

Habermasi, kritikën drejtuar postmodernizmit nga ekolet e ndryshme postmoderne, i vlerëson si anti-iluministe dhe si formë e reagimit irracional. Ai, mbron modernitetin me tezën se, moderniteti akoma paraqet një projekt të papërfunduar me potencial të fuqishëm për t'u zhvilluar.

Kritika e Habermasit ndaj postmodernistëve më së shumti drejtohet në temat si, indiferenca ndaj argumenteve, mbrojta e subjektivizmit, mohimi total i ndarjes së shkencës, fesë, filozofisë, artit, dhënia prioritet retorikës dhe shkrimit para mbizotërimit të hierarkisë fonologjike dhe logjike. Sipas Habermasit, mohimi i modernitetit, a priori do të thotë të injorosh të gjitha sukseset e arritura të demokracisë në vendet perëndimore si dhe mohimin total të koncepteve legjitimuese të këtyre sukseseve. Postmodernistët me teoritë e tyre mohojnë gati se gjithë shkencën sociologjike. Sipas Habermasit, postmodernistët duke i njëjtësuar dhe barazuar konceptet si; bota moderne, laicizimi, racionalizmi, merkantilizmi, determinizmi, kapitalizmi, industrializmi, post-industrializmi, teknologjizmi, intelektualizimi, objektivizimi, scientizimi, progresi, iluminizmi, pozitivizmi, demokracia, kundërshtojnë në total. Në fund të gjithë këto koncepte që janë objekt studimi të sociologjisë do të thotë të shpesh atë në gjendje jofunksionale. Të pohuarit së moderniteti ka përfunduar do të thotë që ka përfunduar edhe shkenca e sociologjisë. Gellner mendon se postmodernizmi në një farë mënyre kritikon edhe relativizmin, Ai, “ *Postmodernizmi paraqitet si lëvizje tolerante, kurse toleranca përbën boshtin kryesor të idesë postmoderne, gjithçka është në përpjesëtim të drejtë me tolerancën. Sipas meje kjo është një marrëzi! Mendimi, që të gjithë njerëzit në masë të njëjtë gëzojnë të drejta të barabarta dhe që të gjithë besimet në masë të njëjtë janë të barabarta paraqet një mendim të gabuar. Kjo ide orienton në idenë se të gjithë njerëzit posedojnë karakteristika të njëjta. Kjo është një marrëzi!*”(Yılmaz, 1998:56).

Gjithashtu në këtë debat kyçet edhe Giddensi, i cili në veprën e tij “*Rezultatet e Modernitetit*”, mohon që është hyrë në periudhën e postmodernizmit. Giddensi në këtë vepër shqyrton multidimensionet e modernizmit në nivel institucional. Sipas tij dimensionet e modernitetit janë: Kapitalizmi (akumulimi i kapitalit në lidhshmëri me tregun e produkteve dhe punën konkurruese), industrializimi (transformimin e natyrës), pushteti ushtarak (kontrolli i mjeteve të dhunës në kuptimin e industrializimit të luftës) dhe observimi

(paraqet kontroll i informacionit dhe inspektimit shoqëror). Në këtë kontekst *“strukturalisht, moderniteti është globalizues”*, kurse dimensionet e globalizimit janë: sistemi i shtetit-komb, ekonomia kapitaliste, rendi ushtarak botëror dhe ndarja e punës ndërkombëtare. Kështu sipas Giddensit postmodernizmi nuk paraqet një periudhë të re, por postmodernizmi reflekton një periudhë të radikalizimit të rezultateve të modernizmit dhe globalizimit të botës. Sipas tij, parametrat kryesorë të modernitetit, kapitalizmi, shteti komb dhe industrializimi, vazhdojnë akoma aktualitetin dhe vlefshmërinë e tyre. (Bayhan,2006, 89).

### Conclusion

Postmodernism is manifested as a new tendency in the creation of a free, a happier and a more peaceful world. Postmodernism is based on its principles, especially on modernist values. According to many authors, postmodernist theory's roots flows from German philosophers, like Nietzsche - a distinguished thinker for his critics toward positivism, idealism (his famous sentence about the interpretation of phenomenon) and Heidegger's radical historicism. Postmodernists, like Frankfurt school's theoreticians thought, opened a new field of understanding individual freedom after reviewing and criticizing the modernist's social theories, which are actually based on enlightenment philosophy - those thinkers who want to continue the independent existence from the dominant paradigm. Postmodernism, instead of one reason refers the idea of many reasons and creates an authentic philosophy, based in Wittgenstein's language games and Gadamer's hermeneutic.

Leotard, on the other hand, with his criticism towards rational and universal tendencies of the modern philosophy, tries to create a new social theory based on the cultural and heterogeneous diversity. “Man is not just a human being who produces ideas and thoughts. Parts of it are feelings, values, beliefs, which constantly connect him with the outdoor world. That's how man (through these inner changes) represents a transforming being. The greater narration of

the modern era is replaced by language games and micro-narrations. Like Leotard did, Baudrillard reiterated the same defectives of the modern paradigm, trying to emphasize that “we are living in a new period now”.

Finally, we can conclude that the scientific phenomenon theoreticians calls as postmodernism, is not defined yet of what it really represents, considering its theoretical undefined character of specifics and breaking points from modernism. However, postmodernism as a scientific and an intellectual phenomenon, especially in western countries, which is raising debates and polemics among several intellectuals, getting the academic circles' attention. Since postmodernism cannot be transformed in an ideology and in an alternate movement due to the extreme skepticism towards phenomenon, institutions and western society's values, risks to get transformed in a nihilist movement.

#### LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Babaroğlu, Metin, *Aydınlanma Sorunu ve Değerler*, İstanbul, Ayna, 2002.

Baudrillard, Jean, *Tüketim Toplumu, Söylencileri-Yapılar*, İstanbul, Ayrıntı, 2012.

Bayhan, Halil, *Ulus Devlet, Modernizm ve Postmodernizm*, Dicle Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Kamu Hukuk Ana Bilim Dalı (Temel magistrature të pabotuar), Diyarbakır, 2006.

Calinescu, Matei, *Modernliğin Beş Yüzü, Modernizm, Avangard, Dekadans, Kitsch, Postmodernizm*, (Përkthyes nga Anglishtja: Sabri Gürses), İstanbul, KÜRE, 2013)

Callinicos, Alex, *Toplum Kuramı, Tarihsel Bir Bakış*, (Përkthyer nga anglishtja: Yasemin Tezgiden,) 2004

Cevizci, Ahmet, *Felsefe Sözlüğü*, İstanbul, Say, 2012.

Childs, Peter, *Modernizm*, (Përkthyes nga Anglishtja: Vural Yıldırım), Ankara, Sitare, 2008.

Çiğdem, Ahmet, *Aydınlanma Düşüncesi*, İstanbul, İletişim, 2013.

Demir, Zekije, *Feminizmi modern dhe postmodern*, (Përkthyes nga Turqishtja: Ali Pajaziti), Shkup, Logos A, 2006.

Featherstone, Mike, *Postmodernizm ve Tüketim Kültürü*, (Përkthyer nga Anglishtja: Mehmet Küçük), İstanbul, Ayrıntı, 2011.

Guenon, Rene, *Modern Dünyanın Bunalımı*, (Përkthyes nga Frëngjishtja: Mahmut Kamık), Ankara, HECE, 2012.

Harvey, David, *Postmodernliğin Durumu*, (Përkthyes nga Anglishtja: Sungur Savran), İstanbul, Metis, 2012.

Kızılçelik, Sezgin, *Postmodernizm Dedikleri*, İstanbul, Saray, 1996

Kumar Krishan, *Sanay Sonrası Tplumdan Post-modern Topluma, Çağdaş Dünyanın Yeni Kuramları*, (Përkthyes nga Anglishtja: Mehmet Küçük), Ankara, Dost, 2013.

Küçük Mehmet, *Modernite versus Postmodernite*, İstanbul, Say, 2011.

Loytard, Jean François, *Postmodern Durum*, (Përkthyes nga Frëngjistja: İsmet Birkan), Ankara, Bilgesu, 2013.

Sarup, Madam, *Postyapısalcılık ve Postmodernizm*, (Përkthyer nga Frëngjishtja: Abdülbaki Güçlü), Ankara, Bilim ve Sanat, 2004

Şaylan Gencay, *Postmodernizm*, Ankara, İmge, 2009.

Uyank, Necip, *Ayndınlanma Felsefesinde İlerleme Düşüncesi ve Etkileri*, Dicle Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Felsefe Ana Bilim Dalı, (Temë magjistrature e pabotuar), 2006.

Yılmaz, Aytekin, *Modernden Postmodern Siyasal Arayışlar*, Ankara, Vadi, 1998.